

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E ENJTE 21 KORRIK 2022

Zonja Kryetare, përveçse jeni duke shkelur në mënyrë sistematike prej gati dy muajsh Rregulloren, në fakt, sot sapo arrite edhe në një pikë tjetër, duke gënjyer. Ndjesë që po ta them, por sapo gënjeve! Ka një projektrezolutë të paraqitur nga unë, si kryetar i grupit parlamentar, më 27 maj, ka një projektrezolutë tjetër nga disa deputetë, nga disa kolegë, të cilat ngjajnë si dy pika ujë. Dakord? Dhe, po të doni ju, me gjithë divergjencat që mund të kem unë me zotin Shehu, e kam gjetur gjuhën në Komisionin për Politikën e Jashtme, jashtë Rregullores, thjesht dhe vetëm për të hequr çdolloy alibie tuajën.

Ishim në Komisionin për Politikën e Jashtme, e prezantova, e gjeta dhe gjuhën me zotin Sheun. Kemi mbaruar punë. Një projektrezolutë është ajo! Duhej të ishte futur në seancë që në datën 27 qershor. Kaloi qershori, po kalon korriku dhe me alibi të tilla, zonjë, nuk mund ta shtysh. Këtu është fare e qartë, ju thatë: “Kosova nuk mund të na ndajë”. Po bëheni ju shkak për të krijuar një ndarje artificiale. Se cila është arsyeja, unë nuk e di. Në fakt, e di, por ta kanë lënë ty qyrkun për ta nxjerrë këtu dhe për të ulur kokën të gjithë kolegët e tu. Ke detyrim ligjor, ke detyrim kushtetues, ke detyrim nga Rregullorja që një projektrezolutë, sipas Rregullores së këtij Kuvendi, në bazë të neneve 98 dhe 99, jo vetëm ta kalosh në Konferencë, por ta sjellësh në seancë, ku të gjithë këtu, burra dhe gra, të shprehin shqetësimin e tyre për një gjendje, për një situatë e për një konsideratë ligjore shumë të rëndësishme: gjenocidin serb në Kosovë.

Këtij togfjalëshi i largoheni si djalli nga temjani. Pse duhet ta bëni këtë gjë? Këtu do ta keni përherë, në çdo seancë, nuk i shmangeni dot. Siç ua thashë edhe kolegëve të Komisionit për Politikën e Jashtme, duhet kurajë intelektuale për ta përballuar këtë situatë dhe për ta çuar para. Zonjë, e keni detyrim, e keni detyrim tani. Është seanca e fundit e këtij sesioni. Ja ku jemi të gjithë! Të gjithë përgjërohemi për çështjen e Kosovës, të krimeve dhe të masakrave në Kosovë. Është detyrim, së pari, politik, së dyti, moral dhe, së treti, institucional, për ta votuar dhe për ta diskutuar atë projektrezolutë, ato projektrezoluta. Ne nuk kemi asnjë lloj diskutimi,

asnjë lloj diskrepanse me njëri-tjetrin për këtë çështje, se Kosova na bashkon. Ju po bëheni shkak që të krijoni një hendek artificial. Barrën do ta mbani ju!